FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 90 30 maj 2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8182 datë 21.5.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	3791
Dekret nr. 8197 datë 24.5.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	3791
Vendim i KM nr. 391, datë 3.4.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore"……	3792
Vendim i KM nr. 412, datë 21.5.2013	Për miratimin e procedurave të përzgjedhjes dhe të emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave……	3792
Vendim i KM nr. 413, datë 15.5.2013	Për rialokimin e numrit të punonjësve dhe të fondeve buxhetore për vitin 2013, ndërmjet Institutit të Gjeografisë Ushtarake dhe Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor……	3795
Vendim i KM nr. 414, datë 15.5.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 327, datë 29.4.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në fond banese të ish-objekteve të dala nga ristrukturimi i Ministrisë së Brendshme (repartit ushtarak nr. 5715), "Kodra e Priftit", Tiranë, me qëllim privatizimin, në emër të banorëve, nga Enti Kombëtar i Banesave……	3796
Vendim i KM nr. 415, datë 15.5.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, të sipërfaqes 10 000 m^2, truall, pjesë e pronës nr. 101, reparti 5011, Rrapi i Treshit, Tiranë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar……	3797

Vendim i KM nr. 416, datë 15.5.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 89, datë 16.1.2013 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2013", të ndryshuar……	3810
Vendim i KM nr. 417, datë 15.5.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetases Brunilda Hyka……	3810
Vendim i KM nr. 418, datë 15.5.2013	Për rritjen e aksioneve të Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim……	3811
Vendim i KM nr. 419, datë 15.5.2013	Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë……	3811
Vendim i KM nr. 421, datë 15.5.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar……	3813
Vendim i KM nr. 424, datë 15.5.2013	Për miratimin e listës së shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë për periudhën 25 maj deri më 25 shtator 2013……	3817
Vendim i KM nr. 425, datë 15.5.2013	Për lirimin, mandatimin dhe rimandatimin e disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit……	3818
Vendim i KM nr. 426, datë 15.5.2013	Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën……	3818
Vendim i KM nr. 427, datë 15.5.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga rikonstruksioni i rrugës Qendër Kryevidh, shkolla 9-vjeçare në komunën e Kryevidhit të qarkut të Tiranës……	3820
Vendim i KM nr. 428, datë 15.5.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Bershi-Klos" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë……	3821
Vendim i KM nr. 430, datë 15.5.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 165, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën e Fierzës të qarkut të Kukësit"……	3821
Vendim i KM nr. 431, datë 15.5.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Katund i Ri të qarkut të Durrësit……	3823
Vendim i KM nr. 432, datë 15.5.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Zharrëz të qarkut të Fierit……	3824
Vendim i KM nr.458, datë 28.5.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr.183, datë 13.3.2013 të Këshillit të Ministrave "Për shpërndarjen pjesore të të ardhurave nga privatizimi i "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" dhe "Hec Ulëz-Shkopet""……	3825
Kërkesë e MPPT nr. 467/20 datë 20.5.2013	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (sipërfaqet dhe kulturat drufrutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – "Rruga e Kavajës")"……	3826

DEKRET
Nr. 8182, datë 21.5.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Sezer Akif Erdoğan
2. Aynur Mehmet Erdoğan
3. Enes Erdem Sezer Erdoğan
4. Ayşe Irem Sezer Erdoğan
5. Esat Niyazi Gültaşlar
6. Anna Kathryn Jeremy Harris Manga (Reeves)
7. Simon Gjoka Shkrela
8. Julien-Gerarad Emile Louis Marius Charles Roche

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8197, datë 24.5.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Azdren Gani Llullaku
2. Jurgen Fatmir Gjasula
3. Amir Malush Abrashi
4. Ilir Sylejman Berisha
5. Vullnet Xhevat Basha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 391, datë 3.4.2013

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e Ministrit të Financve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3 dhe që i bashkëlidhet vendimit nr. 418, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave, në emërtesën e bordit/këshillit/komisionit në funksion të Këshillit të Lartë të Drejtësisë shtohet Komisioni i Mbrojtjes së Gjyqtarëve. Ky komision përbëhet nga 1 kryetar dhe 4 (katër) anëtarë me të drejtë pagese në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në një vit buxhetor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 412, datë 21.5.2013

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE TË EMËRIMIT TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) "Ligji i statistikave zyrtare", ligji nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar;

b) "INSTAT", Instituti i Statistikave;

c) "Drejtori i përgjithshëm", drejtori i përgjithshëm i Institutit të Statistikave;

ç) "Këshilli", Këshilli i Statistikave.

2. Përcaktimi i procedurave dhe i kritereve të përzgjedhjes dhe rekrutimit të drejtorit të përgjithshëm, ka për qëllim të sigurojë drejtimin e Institutit të Statistikave në mënyrë profesionale, të pavarur dhe me integritet të lartë moral, nëpërmjet kryerjes së procedurave transparente përzgjedhëse, duke u mbështetur në kritere tërësisht profesionale për të përballuar detyrat e përcaktuara në ligjin e statistikave zyrtare.

3. Përzgjedhja e kandidaturave për drejtorin e përgjithshëm kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurës së hapur të rekrutimit nga Këshilli i Statistikave, bazuar në pikën 3 të nenit 9 të ligjit të statistikave zyrtare, të ndryshuar.

KREU II
SHPALLJA E KONKURRIMIT TË KANDIDATËVE

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga lirimi i drejtorit të përgjithshëm, Këshilli, në zbatim të pikës 3 të nenit 9 të ligjit të statistikave zyrtare, përgatit dokumentacionin dhe shpall në media vendin e lirë për titullarin e institucionit.

2. Këshilli i Statistikave, me shpenzimet e INSTAT-it, boton shpalljen e konkurrimit për vendin e lirë në dy gazeta me qarkullim më të madh kombëtar dhe në faqen elektronike të INSTAT-it. Botimi bëhet, të paktën, 20 (njëzet) ditë para datës së caktuar për zhvillimin e testimit, tri ditë me radhë.

3. Shpallja e konkurrimit për vendin e lirë përmban këto të dhëna:

a) Një përshkrim të shkurtër të natyrës së punës dhe funksionit që do të mbulojë;

b) Kërkesat për pranimin e kandidatëve;

c) Listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;

ç) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen për fazën e testimit;

d) Datën dhe vendin e zhvillimit të testimit;

dh) Fushën e njohurive që do të testohen, llojet e testeve, si dhe bibliografinë përkatëse.

4. Krahas kërkesave të përgjithshme, të parashikuara në pikën 3/1 të nenit 9 të ligjit të statistikave zyrtare, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kërkesat e përgjithshme për t'u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

5. Këshilli mund të përcaktojë kërkesa të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, fushat për të cilat do të testohen kandidatët dhe datën kur do të zhvillohet konkurrimi. Përcaktimi i këtyre kërkesave mbështetet në specifikën e detyrës që do të mbulojë drejtori i përgjithshëm sipas ligjit të statistikave zyrtare.

KREU III
PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE E TESTIMIT TË KANDIDATËVE

1. Procedura e përzgjedhjes dhe e testimit të kandidatëve përfshin dy faza:

a) Faza e përzgjedhjes së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkurrimit, gjatë së cilës shqyrtohet dokumentacioni i kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozicion pune. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Këshilli harton listën e kandidatëve të kualifikuar për fazën e dytë, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data përfundimtare për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët.

b) Faza e testimit, gjatë së cilës kryhet intervistimi i kandidatëve për të vlerësuar njohuritë që zotërojnë kandidatët në fushën e statistikave, filozofinë drejtuese të tyre, strategjitë dhe risitë që mund të sjellin gjatë zbatimit të këtij funksioni drejtues. Testimi i kandidatëve kryhet jo më parë se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë.

2. Në fazën e përzgjedhjes së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkurrimit veprohet si më poshtë vijon:

a) Këshilli i Statistikave bën verifikimin paraprak të kandidatëve, të cilët, në bazë të fotokopjeve të dokumenteve të paraqitura, përmbushin kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkursit;

b) Për garantimin e paanshmërisë së veprimtarisë së anëtarëve të Këshillit të Statistikave, zbatohen nenet nga 37 deri 43 të Kodit të Procedurave Administrative. Në rast të konstatimit të rasteve të parashikuara në këto nene, anëtari në fjalë i Këshillit të Statistikave jep dorëheqjen nga procesi i vlerësimit të kandidatëve dhe nuk përfshihet në asnjë hap të mëtejshëm të këtij procesi;

c) Kandidatët, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe që do të marrin pjesë në testim, renditen sipas rendit alfabetik. Personat, që nuk plotësojnë kërkesat e sipërpërmendura renditen në një tjetër listë, ku tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Listat e mësipërme shpallen në kohën e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij kreu;

ç) Brenda dy ditëve nga shpallja e listave, personat e interesuar mund të paraqesin ankesat në Këshillin e Statistikave. Ankesat shqyrtohen dhe zgjidhen nga Këshilli brenda 3 (tri) ditëve nga

depozitimi i tyre. Dokumentacioni i shqyrtimit të ankesave dhe mënyrës së zgjidhjes së tyre është pjesë e dokumentacionit të testimit që i dorëzohet Kryeministrit për caktimin e kandidatit fitues sipas pikës 2 të kreut V të këtij vendimi.

3. Për fazën e testimit veprohet si më poshtë vijon:

a) Testimi zhvillohet me gojë në ditën dhe në vendin e caktuar në shpalljen e konkursit;

b) Këshilli i Statistikave përcakton subjektet e testimit në këto fusha:

i) njohuri në fushën e statistikave dhe përmbajtjen e programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare;

ii) njohuri për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative dhe për legjislacionin dhe funksionimin e administratës publike;

iii) njohuri për legjislacionin mbi të cilin mbështetet funksionimi i sistemit kombëtar statistikor;

iv) filozofinë drejtuese;

v) strategjitë dhe risitë që mund të sjellin gjatë zbatimit të këtij funksioni drejtues.

c) Lidhur me përcaktimet e nënndarjeve "iv" e "v" të shkronjës "b" të kësaj pike, kandidatët mund t'i paraqesin Këshillit edhe një prezantim të shkurtër në format *Power Point*.

KREU IV
VLERËSIMI I KANDIDATËVE

1. Këshilli i merr vendimet në prani të të gjithë anëtarëve të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në shkronjën "b" të pikës 2 të këtij kreu.

2. Këshilli shqyrton plotësimin e kritereve të parashikuara në pikën 2 të kreut III të këtij vendimi dhe vlerëson kandidatët e klasifikuar në bazë të treguesve të mëposhtëm:

a) Rezultateve të studimeve universitare apo pasuniversitare;

b) Përvojave të mëparshme në punë që lidhen me pozicionin;

c) Vlerësimeve të punës;

ç) Trajnimeve apo specializimeve të ndryshme;

d) Të dhënave për studimet e kryera apo botimet në fusha që i shërbejnë pozicionit;

dh) Të dhënave për integritetin moral;

e) Të dhënave për masa disiplinore;

ë) Të dhënave për aftësi të spikatura organizative dhe menaxhuese;

f) Çdo të dhëne tjetër që tregon përparësi të kandidatit përkatës ndaj kandidatëve të tjerë.

3. Pikëzimi i testimit bëhet sipas vlerësimit me pikë nga 1 në 10 për çdo kriter, në përputhje me pikën 2 të këtij kreu, dhe për çdo pyetje drejtuar kandidatëve gjatë fazës së testimit. Pyetjet duhet të jenë të barabarta dhe të së njëjtës natyrë për të gjithë kandidatët.

4. Këshilli përgatit një listë të kandidatëve, sipas rezultateve të arritura, duke filluar nga ai me më shumë pikë. Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, renditja bëhet sipas rezultateve të hedhjes në short. Lista e renditjes së kandidatëve u dorëzohet këtyre jo më vonë se 2 (dy) ditë nga data e zhvillimit të testimit.

5. Këshilli i propozon Kryeministrit jo më shumë se tri nga kandidaturat e paraqitura, të cilat plotësojnë kërkesat e mësipërme dhe krijojnë bindjen e Këshillit për aftësinë e tyre profesionale në fushën e prodhimit statistikor dhe drejtimit të një organizate.

6. Kryeministri zgjedh njërin prej tre kandidatëve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kandidaturave të propozuara nga Këshilli i Statistikave. Për këtë qëllim, Kryeministri zhvillon paraprakisht një bashkëbisedim me secilin nga tre kandidatët e propozuar nga Këshilli.

7. Këshilli, brenda 4 (katër) ditëve nga miratimi i Kryeministrit, shpall kandidatin fitues në dy gazetat me qarkullim më të madh kombëtar.

KREU V
DISPOZITA TË TJERA DHE KALIMTARE

1. Këshilli i Statistikave mban dokumentacionin e procedurës së rekrutimit dhe një kopje të dosjes së aplikantëve në arkivin e INSTAT-it.

2. Propozimi i kandidaturave Kryeministrit shoqërohet me dokumentacionin e plotë administrativ të rekrutimit dhe një kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët aplikantë të propozuar.

3. Për përmbushjen e detyrave të tij në zbatim të ligjit për statistikat zyrtare dhe të këtij vendimi, Këshilli i Statistikave asistohet nga sekretariati i Këshillit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve pranë INSTAT-it.

4. Ngarkohet Këshilli i Statistikave, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të fillojë procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të INSTAT-it.

5. Drejtori i përgjithshëm aktual i INSTAT-it qëndron në këtë funksion deri në përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatit fitues nga Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 413, datë 15.5.2013

PËR RIALOKIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2013, NDËRMJET INSTITUTIT TË GJEOGRAFISË USHTARAKE DHE AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) t'i shtohen 21 (njëzet e një) punonjës për vitin 2013 nga reduktimi i 40 (dyzet) punonjësve të Institutit të Gjeografisë Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6010) në Ministrinë e Mbrojtjes, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve në nivel ministrie, për vitin 2013, në 10 150 (dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) veta.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin "Shërbime për shoqërinë e informacionit", të shtohet fondi 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë për shpenzime korente për ASIG-un, i cili të përballohet nga reduktimi, në të njëjtën masë, i shpenzimeve korente të programit "Mbështetja e luftimit" (Reparti Ushtarak nr. 6010) të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 414, datë 15.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 327, DATË 29.4.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN NË FOND BANESE TË ISH-OBJEKTEVE TË DALA NGA RISTRUKTURIMI I MINISTRISË SË BRENDSHME (REPARTIT USHTARAK NR. 5715), "KODRA E PRIFTIT", TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMIN, NË EMËR TË BANORËVE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve", të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore" dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr. 327, datë 29.4.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Pas kalimit të këtyre objekteve në fond banesash dhe regjistrimit të tyre në ZVRPP-në e Tiranës, Enti Kombëtar i Banesave ngarkohet të lidhë pa kundërshpërblim (vlerën e objektit dhe truallit funksional) kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, të përcaktuat në listat emërore sipas familjeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Shpenzimet operacionale të Entit Kombëtar të Banesave dhe shpenzimet hipotekore të përballohen nga përfituesit.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E ISH-PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK QË BANOJNË NË OBJEKTET E ISH-REPARTIT USHTARAK NR. 5715 TE "KODRA E PRIFTIT", TIRANË

Nr. emër, mbiemër, nr. i godinës		**Nr. emër, mbiemër, nr. i godinës**	
1. Viktor Hysaj	2	23. Nuredin Dervishi	6
2. Fatmir Leli	2	24. Abaz Balla	6
3. Hasan Pashai	14	25. Perlat Leli	7
4. Arben Hasani	14	26. Arben Alikaj	7
5. Vladimir Bisha	14	27. Ziadet Llanaj	7
6. Ylli Myslimaj	14	28. Ndoc Çardaku	7
7. Sadri Ymaj	3	29. Bujar Dusha	7
8. Petrit Lamnica	3	30. Isyf Kateshi	8
9. Ndriçim Tomorri	4	31. Naim Spahiu	8
10. Edmond Domi	1	32. Naim Sinani	8
11. Sherif Quku	1	33. Artur Gajtani	8
12. Bedri Mersini	1	34. Xhevdet Guga	8
13. Gëzim Shaholli	1	35. Bislim Berisha	8
14. Shkëlqim Hasani	1	36. Jashar Bakiasi	8
15. Xhavit Zyka	1	37. Pirro Davidhi	8
16. Vido Prifti	1	38. Mihallaq Çuko	8
17. Fatos Çaushi	1	39. Bashkim Selimi	8
18. Vlash Buna	1	40. Sejdin Lloci	8
19. Tanush Arapi	1	41. Mersin Maknori	8
20. Gëzim Haxhisi	6	42. Fadil Elezi	8
21. Xhevdet Hyka	6	43.Sejfulla Maxhelaku	11
22. Durim Harizi	6	44. Besnik Zela	12

VENDIM
Nr. 415, datë 15.5.2013

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË SIPËRFAQES 10 000 M², TRUALL, PJESË E PRONËS NR. 101, REPARTI NR. 5011, RRAPI I TRESHIT, TIRANË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 14 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, të sipërfaqes 10 000 (dhjetë mijë) m^2 truall, pjesë e pronës nr. 101, Reparti nr. 5011, Rrapi i Treshit, Tiranë, sipas formularit bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave dhe që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t'u përdorur për ndërtimin e banesave për qytetarët e pastrehë të sistemuar aktualisht në godinat e Universitetit Bujqësor dhe në godinën e ish-Institutit të Kërkimeve Biologjike, Tiranë.

2. Përfituesit e këtyre banesave të jenë qytetarët e pastrehë, të sistemuar aktualisht në godinat e Universitetit Bujqësor, Tiranë dhe në godinën e ish-Institutit të Kërkimeve Biologjike, Tiranë. Lista me emrat e përfituesve i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ndërsa dhjetë për qind e banesave të ndërtuara të jenë për ushtarakët e pastrehë të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Bashkia e Tiranës të marrë masat dhe të lehtësojë procedurat për pajisjen me lejet përkatëse.

4. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

5. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Entit Kombëtar të Banesave u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Bashkia e Tiranës, Enti Kombëtar i Banesave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

				Tunel municioni		1238				
				Truall		35722				
101			Rep.5011 Depo Ushqimit			15416 M2	Per Mbrojtjen	MM Rep. Nr.5010 Tirane	Rep.Usht. Nr.5011, Tirane	
			Rrapi Treshit, Tirane	Trup-roje	Tirane	530				
				Park telaje		237				
				Depo		420				
				Depo		272				
				Depo		210				
				Depo		210				
				Depo		371				
				Depo		392				
				Depo		512				
				Depo		300				
				Depo		300				
				Ish depo kripe		122				
				Truall		11540				
102			Qendra e Nderlidhjes			9791 M2	Për Mbrojtjen	MM Rep.Nr. 2001 Durres	Rep.Usht Nr.2001 Durres	
			Linxe, Tirane	Q.nderlidhje tip tunel	Tirane	101				
				Depo nderlidhje kazerm.		66				
				Lokal motorrash		27				
				Banjo WC		9				
				Depo rikupero		130				
				Menze kuzhine fjetine kabinet		141				
				Depo qymyri		24				
				Truall		9395				
103			Bateria AKA ish rep.4225/2			24000 M2	Per Mbrojtjen	MM Rep.3400 Tirane	Rep.Usht. 3030 Tirane	Dhene per bariese

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 1

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Numri i frymëve	Numri i dhomave që posedojnë
1	Myftar Xhekalia	5	1
2	Xhetan Perleka	2	1
3	Liljana Dedolli	2	1
4	Fari Sallaku	5	2
5	Flamur Doçi	5	1
6	Tahir Kolaveri	5	2
7	Bajram Almuça	3	1
8	Aqif Markola	5	2
9	Shpëtim Ibrahim Bulqiza	5	1
10	Roland Ramadan Daullxhiu	5	1
11	Albert Ramadan Daullxhiu	5	1
12	Petrit Nik Mulaj	5	2
13	Prend Murat Mulaj	2	2
14	Gjon Nik Mulaj	7	2
15	Gëzim Qazim Memia	4	1
16	Agim Margjeshi	3	2
17	Besnik Lan Kortoçi	3	1
18	Fatime Xhem Kortoçi	4	1
19	Zihni Bode	5	1
20	Mimoza Naçi	4	1
21	Fatmir Gashi	4	1
22	Dashamir Lan Koldoçi	3	1
23	Refije Daullxhiu	1	1
24	Skënder Din Syla	4	1
25	Bilbil Lan Koldoçi	2	2
26	Paulin Kol Bakraxhi	2	1
27	Blerim Isaku	5	1
28	Bujar Sabri Mera	4	1
29	Dukate Smajl Hasani	3	1
30	Lek Smajl Vatinika	7	sallë
31	Aranit Musa Imeraj	4	sallë
32	Azem Bajram Dynisha	5	1
33	Selim Ram Byberi	8	2
34	Hamid Ram Byberi	3	1
35	Xhevair Ram Bybyri	3	1
36	Emiliano Skënder Berisha	3	1
37	Sadik Ram Byberi	5	1
38	Halit Shaban Çuni	5	2
39	Fatmir Din Boshnjaku	4	1
40	Florjan Demirali Boçka	5	2
41	Zef Ndue Bushgjaka	6	1
42	Dilaver Ismail Shega	5	1
43	Agron Xhevit Arapi	5	1
44	Skënder Selim Ulliri	4	1
45	Azem Sadri Mulaj	2	1
46	Sokol Preng Prebibaj	7	2
47	Edmond Nikoll Pjetri	4	1

48	Firduze Hambari	1	1
49	Qemal Veli Veliu	3	2
50	Ilir Gjon Mrroku	5	sallë
51	Fatmir Ali Brahushi	4	1
52	Monda Hima		2
53	Zef Marku	6	2
54	Skënder Berisha	3	1
55	Nikoll Shtjefën Pjetri	6	2
56	Agostin Zef Mili	5	2
57	Agim Koka	6	2
58	Bashkim Zenel Myftari	7	2
59	Ylli Biberi	1	1
60	Viorel Lesi	2	1
61	Martin Vat Shpenza	5	2
62	Hysni Maliq Gjon	9	2
63	Zef Ndrec Pergjegaj	4	2
64	Artur Daullxhiu	3	1
65	Djana Daullxhiu	3	1
66	Gegë Gjon Pepkola	7	sallë
67	Nush Gjini	1	1
68	Brahim Halil Dusha	9	sallë
69	Pal Preng Kola	5	2
70	Gjon Lekani	1	1
71	Astrit Preng Marleka	4	2
72	Gëzim Lulash Ndou	5	1
73	Katrina Pjetër Ndou	5	2

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 2

Nr.	**Emri, atësia, mbiemri**	**Numri i frymëve**	**Numri i dhomave që posedojnë**
1	Hasan Mehmet Kurtsmajli	4	2
2	Përparim Bilal Hajdari	3	2
3	Kadife Bilal Hajdari	3	1
4	Qeramet Ramë Prengazi	5	2
5	Shkëlzen Din Avdia	4	1
6	Ilir Din Avdia	4	1
7	Aleksandër Gjikola	5	1
8	Çaush Deliukcama	3	1
9	Sali Osman Danaj	6	2
10	Nderim Isa Osmanaj	9	3
11	Nexhip Ahmet Duraku	5	2
12	Ali Shaban Osmani	4	1
13	Çbene Gjoni	2	1
14	Kujtim Sherif Rexha	4	1
15	Ylli Hamid Cukali	3	2
16	Islam Avdi Cukali	4	1
17	Osman Doçi	5	sallë
18	Halil Elez Mema	6	2
19	Sokol Jak Ndrepepa	4	2
20	Artan Veli Valoci	1	1

21	Qerim Muhamet Mulgeci	2	1
22	Adil Azem Lushaj	4	2
23	Hamide Mandri	3	1
24	Mira Elezi	4	2
25	Naim Destan Buçi	5	2
26	Rexhep Malo Çelaj	6	2
27	Lulzime Murati	5	1
28	Dëfrim Muhamet Mulgeci	4	1
29	Kujtim Muhamet Mulgeci	2	1
30	Ismet Ram Mulgeci	5	2
31	Astrit Ali Korloçi	4	1
32	Ismet Brahim Vaka	3	1
33	Hyre Bajram Durmisha	3	1
34	Granit Sokoli	3	sallë
35	Gladiola Ymer Ponari	2	1
36	Shefki Sali Kriku	4	1
37	Brahim Musli Hasandoçaj	4	1
38	Eduard Brahim Hasandoçaj	4	1
39	Jani Qazim Memia	4	1
40	Tahir Hysen Buçpapa	5	2
41	Tefik Shaban Vlashi	4	2
42	Fejzi Bislim Madani	4	2
43	Klodiana Pozlloni	3	1
44	Zenun Halil Selimaj	4	2
45	Eduard Zenun Selimaj	2	1
46	Petrit Bajram Shukli	8	1
47	Shaban Niman Lata	4	1
48	Besan Imer Ponari	4	2
49	Aranit Aqif Markola	3	2
50	Zenel Zymer Toskaj	3	1
51	Shkëlzen Zymer Toskaj	4	1
52	Niman Ukë Lata	4	sallë
53	Sami Niman Lata	4	sallë
54	Rahman Shaban Vlashi	4	2
55	Halit Adem Kurti	2	1
56	Perlat Rexhep Rustemaj	4	1
57	Astrit Rexhep Rustemi	4	1
58	Qazim Rexhep Rustemi	5	1
59	Përparim Bajram Dunisha	4	2
60	Jorgo Malo Çenkollari	4	1
61	Ali Osman Kertoçi	4	1
62	Alfred Ali Kertoçi	1	1
63	Marash Ndue Maletaj	3	1
64	Agron Çup Gjikola	5	1
65	Paulin Losh Gjikola	5	1
66	Saimir Sallahi	bosh	1

85 dhoma 4 salla

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 3

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Numri i frymëve	Numri i dhomave që posedojnë
1	Ibrahim Liman Golemi	6	2
2	Ramazan Shaban Meta	5	2
3	Besnik Nazmi Hyra	1	1
4	Ismail Bilal Hajdari	5	1
5	Sherbet Ramazan Barmeta	4	2
6	Simon Gjon Lleshi	4	2
7	Bajram Dimali	4	1
8	Sali Demiri	5	2
9	Dashnor Ajet Ramallari	4	2
10	Isa Gjoni	5	2
11	Taulant Jani Muka	2	1
12	Gentian Cara	4	1
13	Angjelin Pergjekaj	4	1
14	Lule Kalvoçi	4	2
15	Afrim Skender Sula	3	2
16	Uke Shpend Haklaj	6	3
17	Azem Man Metaliaj	8	1
18	Jakup Bajram Lici	6	1
19	Halil Shpend Madani	5	2
20	Gjergj Bardhi	3	2
21	Asllan Bajram Lici	6	1
22	Gentian Asllan Lici	3	1
23	Mefail Seit Koçi	3	2
24	Asllan Aqif Lushe	5	1
25	Malo Tahir Cankollari	6	1
26	Skënder Rexhep Vata	5	1
27	Sose Rexhep Kertolli	3	1
28	Haki Beqir Dautaj	4	3
29	Murat Nazmi Shehi	6	1
30	Ylvi Hamedan Isaku	5	2
31	Përparim Braho Brahaj	5	2
32	Fatime Ram Brahaj	3	1
33	Agim Ukë Haklaj	2	1
34	Avni Sherif Iberhasaj	5	2
35	Njazi Korita	2	1
36	Selman Hajredin Lena	5	2
37	Ardjan Gosturani	3	1
38	Çelink Shaban Nikoçi	4	2
39	Tomor Muharrem Dymali	4	1
40	Enver Ali Duka	4	2
41	Xhuma Zenel Latifi	4	1
42	Selman Veli Mata	5	1
43	Adem Veli Mata	5	1
44	Bukurie Nikolli	5	1
45	Naim Mustafa Duka	4	2
46	Besnik Ukë Haklaj	4	2
47	Petrit Tahir Selimaj	4	1

48	Petrit Zenun Znunai	5	2
49	Ardjan Muzi Gosturani	7	1
50	Nezir Hasan Shehu	6	1
51	Bujar Rexhep Murati	4	2
52	Ylmi Besim Bajraktari	6	2
53	Gjin Frok Kalthi	4	2
54	Lavdie Toçi	2	1
55	Gëzim Zenun Kernaja	4	1
56	Bule Man Kernaja	2	1
57	Asllan Hamit Hoxha	3	3
58	Bardhok Preng Zefi	4	2
59	Hasan Skënder Sulaj	4	2
60	Hysen Shpend Ahmangjoka	7	2
61	Preng Gjon Gjergji	4	2
62	Behar Azem Metaliaj	2	1
63	Durim Azem Metaliaj	2	1
64	Ylli Hysen Bami	4	2
65	Sami Selim Vatnikaj	4	1
66	Fatmir Vladi	3	2

2x

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 4

Nr.	**Emri, atësia, mbiemri**	**Numri i frymëve**	**Numri i dhomave që posedojnë**
1	Enver Halim Prifti	7	2
2	Zef Mark Grada	5	2
3	Tonin Hilaj	3	2
4	Alvanira Fusha	1	1
5	Zana Fusha	1	1
6	Riza Muja	4	2
7	Fatli Vrekaj	2	1
8	Nurije Rexhep Ismaili	2	1
9	Lulash Bjeshku	4	2
10	Mustaf Ymer Hasani	5	2
11	Dod Bjeshku	2	1
12	Xhafer Ali Mehaj	2	2
13	Ndue Jak Ndou	4	1
14	Seladin Brahaj	4	1
15	Alket Dervishi	3	1
16	Guxim Kapo Senko	4	1
17	Kol Pjetër Delia	5	2
18	Shkëlqim Dimali	4	1
19	Gjergji Frok Mardhoqi	6	2
20	Gëzim Çun Pepepaj	4	1
21	Halil Mal Prengazi	4	2
22	Viktor Bardhok Gjini	4	2
23	Gjin Preng Kolaj	5	1
24	Mehmet Rrodhja	1	1
25	Petrit Nezir Kurti	4	2
26	Josif Jonuz Shyti	4	1
27	Gjok Ded Dushku	5	2

28	Adriatik Ali Saraçi	5	1
29	Martin Ded Fiku	5	2
30	Mhill Zef Pjetërgjoka	6	2
31	Agim Kasem Çuni	6	2
32	Qemal Din Avdia	5	2
33	Bajram Tahir Skana	5	2
34	Selman Sala	4	2
35	Dallëndyshe Shahini	5	2
36	Sherif Idriz Ymeraj	3	2
37	Halit Din Boshnjaku	4	2
38	Hajredin Idriz Idrizi	7	sallë
39	Agron Hajredin Imeraj	7	2
40	Violeta Nue Mikeli	1	1
41	Sose Hasan Ramaj	4	2
42	Shefki Brahani	4	2
43	Abdyl Shaban Prozllomi	5	2
44	Arben Idriz Vladi	3	2
45	Ylli Amedin Isaku	5	2
46	Skënder Hamit Leka	6	2
47	Hamit Halil Leka	4	1
48	Simon Zek Kola	4	2
49	Hysen Koxheri	4	2
50	Isuf Rexhep Muceku	7	3
51	Zef Ndue Markaj	7	sallë
52	Korab Mehaz Zyberaj	5	1
53	Agim Osman Vladi	5	1 ose 2
54	Nikolin Martin Rajta	5	1
55	Luan Gjin Kolaj	1	1
56	Bajram Sali Kurti	1	1
57	Nustret Seferi	4	1
58	Vladimir Fran Dodaj	3	2
59	Besmir Prel Zhvani	5	2
60	Kujtim Mzhika	5	1
61	Adriatik Bajraktari	2	1
62	Destani Avni Byberi	5	1 ose asnjë

95 dhoma + 2 salla

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 5

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Numri i frymëve	Numri i dhomave që posedojnë
1	Ermir Muharrem Dymali	5	bodrum
2	Sabah Abdulla Hasani	8	1+1 dyqan
3	Arben Safet Malo	2	1
4	Hamez Arif Mehmetaj	3	2
5	Bledar Hamez Mehmetaj	3	sallë
6	Ramazan Rustem Hoxha	2	sallë
7	Bajram Mustaf Hajdari	4	2
8	Bilbil Jak Uka	4	3
9	Refat Vata	3	2
10	Naim Rustem Kola	5	2

11	Mirjan Hamez Mehmetaj	4	1
12	Kujtim Selimi	3	2
13	Shpëtim Lleshi	4	1
14	Vladimir Servet Çaçellari	5	2
15	disa çuna	?	2
16	Ramazan Ismail Kushi	7	2
17	Fatmir Gjoka	4	sallë
18	Shkëlqim Reshat Zani	4	1
19	Ylli Ismail Cani	5	2
20	Lutfie Gani Mera	3	2
21	Arben Hasan Mera	3	1
22	Man Arif Mehmeti	3	1
23	Elvis Man Mehmeti	1	1
24	Shpëtim Bektash Luzi	3	1
25	Ilmi Mustaf Hajdari	4	2
26	Çlirim Musaj	4	2
27	Prend Marku	4	2
28	Zana Nikolla Kadiu	4	1
29	Lulzim Ramazan Kushi	3	1
30	Mark Ded Delia	2	1

20 dhoma + 3 salla + 1 bodrum + 1 dyqan

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 6

Nr.	**Emri, atësia, mbiemri**	**Numri i frymëve**	**Numri i dhomave që posedojnë**
1	Agim Halil Tishmuçaj	4	2
2	Serma Dema	1	1
3	Kujtim Ferik Balla	5	2
4	Leonard Bajran Rrahmani	4	1
5	Dem Rexhep Nabolli	5	1
6	Ardian Bilal Hajdari	3	1
7	Renato Kujtim Ranxha	3	1
8	Skënder Aliko	4	1
9	Nezir Doku	4	1
10	Irakli Prend Karaj	2	1
11	Agron Gjudia	4	2
12	Lola Adem Gjoçaj	3	1
13	Përparim Matoshi	4	1
14	Beqir Matoshi	3	1
15	Rexh Mehmet Mehmeti	4	2
16	Rodan Hajdarmeta	4	1
17	Bilbil Zenel Buçpapa	3	1
18	Sulejman Cani	3	1
19	Mehmet Ram Ismaili	3	1
20	Qamil Grosh Demushi	5	1
21	Mira Kovaçi	1	1
22	Drita Mahmud Domi	2	1
23	Mirdash Meleq Muçollari	4	1
24	Haxhi Dyleman Pasho	4	1
25	Shkëlqim Pal Delia	4	2

26	Hasie Xhafa	?	1
27	Gulik Harka	4	2
28	Kol Ded Bushkola	5	sallë (3 ndarje)
29	Qazim Reshit Xhangoni	4	sallë (2 ndarje)
30	Ded Avni Ganiroshi	7	1
31	Age Ndrec Lleshaj	5	sallë (2 ndarje)
32	Frrok Pjetër Lekaj	5+1	sallë (3 ndarje)
33	Zamir Qazim Xhangolli	3	sallë (1 ndarje)

34 dhoma + 5 salla (11 ndarje)

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 7

Nr.	**Emri, atësia, mbiemri**	**Numri i frymëve**	**Numri i dhomave që posedojnë**
1	Agron Lutfi Helmi	4	2
2	Ram Gjomakaj	5	1
3	Artan Mejdani	5	2
4	Ylli Bajram Gaci	4	1
5	Sami Ismet Matoshi	4	2
6	Isuf Kuliqi	6	2
7	Flora	1	1
8	Islam Myftari	2	1
9	Adem Abazi	4	1
10	Arben Preng Marku	4	1
11	Martin Voci	1	1
12	Taulant Myftar Ponari	5	1
13	Dod Gjergj Lukaj	8	sallë
14	Pjetër Nik Niklekaj	5	2
15	Behar Skënder Lulaj	4	2
16	Aleksandër Zaim Tushe	3	1
17	Xheladin Haziz Peka	5	2
18	Drizair Hasan Kajnozi	5	1
19	Sokol Shtjefën Nikolla	4	1
20	Luçiano Hazis Xhani	3	1
21	Odeta Veli Berberi	2	1
22	Ramiz Azem Bashukaj	4	1+1/2
23	Zef Gjergj Lala	4	sallë
24	Hasim Zenel Hasandoçi	8	1+1/2
25	Lumturie Tom Gjonaj	1	1
26	Gazment Hasanaj	3	1
27	Agron Gjokë Perbibaj	7	1
28	Fran Qerim Doçi	3	1
29	Uk Haxhi Muja	3	1
30	Arben Hajdar Milushi	4	1
31	Zeqir Hajdar Milushi	4	1
32	Gjergj Ndue Vokrri	6	2
33	Hasan Dalip Misku	5	1
34	Ilir Azem Uruçi	4	1
35	Ramiz Metaliaj	?	1
36	Mejreme Idriz Karaj	4	1
37	Ram Ali Balaj	5	1

38	Servet Kadri Ferrici	4	2
39	Ram Hysen Madani	4	1
40	Ç'bane Mic Madani	3	1
41	Shkëlzen Hysen Madani	4	1
42	Mira Pal Kolbuçaj	3	2
43	Bashkim Rakip Xharja	4	1
44	Avdi Bajram Osmanaj	7	2
45	Marash Dod Ndou	7	1
46	Nurie Ram Qerimaj	5	2
47	Bashkim Hysen Bami	5	2
48	Dylber Hajder Hysko	4	sallë
49	Hekuran Isa Huli	4	1
50	Pjerin Martin Rajta	3	1
51	Përparim Haki Dervishi	4	1
52	Altin Fushaj	3	2
53	Lek Musheqi	6	1
54	Besnik Kadri Farrici	4	1
55	Haxhi Refik Sata	4	2
56	Ndue Gjon Laska	5	2
57	Ndoc Gjergj Arra	4	1
58	Bashkim Gjet Zyziu	6	1
59	Qamil Rustemi	2	1
60	Zef Ndue Peleshi	4	2
61	Brunilda Viktor Cauli	2	1
62	Avni Metaliaj	7	2
63	Tomor Drdja	2	1
64	Alfred Lazer Maneci	3	1
65	Lazer Kol Maneci	2	1
66	Ramiz Riza Domi	6	2
67	Brahim Vakaj	3	2
68	Aleksandër Brahim Vakaj	3	1 ose salla
69	Petrit Kurt Selimi	4	1
70	Groshe Ram Selimi	1	1
71	Guxim Beqir Demushi	6	1
72	Shkëlqim Riza Matoshi	5	sallë
73	Aishe Pashk Matoshi	3	1
74	Dritan Zef Guri	2	2
75	Ndoc Ded Fiku	5	2
76	Leze Sadik Mulaj	3	1
77	Flamur Simon Haxhiu	5	2
78	Agim Selman Kurti	6	1
79	Arben Muharrem Cani	4	1
80	Donika Niman Feleqi	4	1
81	Kujtim Mustaf Cenaj	4	1
82	Fatmira Selim Çerpja	3	1
83	Shkurt Sel Kola	5	2
84	Luiza Hajdar Kaloshi	6	1
85	Defrim Ram Ahmetaj	9	1
86	Shkëlqim Mustafa	4	1
87	Xhovalin Mëhill Perkeqi	6	1
88	Selvie Mus Saraçi	5	1

89	Fatos Destan Saraçi	2	1
90	Besnik Selman Tarja	3	1
91	Xhemal Xhekaliu	?	1
92	Elsa Cenaj	4	2

113 dhoma dhe 5 salla

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË NË GODINËN NR. 8

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Numri i frymëve	Numri i dhomave që posedojnë
1	Ibrahim Sali Franku	2	1
2	Ilir Ibrahim Franku	6	1
3	Halim Uk Margjeka	4	1
4	Lulzim Margjeka	3	1
5	Selajdin Huka	4	2
6	Arjan Haxhi Hoxha	4	2
7	Pjetër Pren Bibaj	5	3
8	Ded Gjondrepepaj	5	1
9	Sulejman Gaçi	5	sallë
10	Fatime Asllan Deda	5	sallë
11	Gëzim Shefqet Kaca	4	sallë
12	Musa Rexhep Kosumi	6	sallë (kt.1)
13	Dritan Sulejman Emini	5	ish- mensa
14	Qerim Teluli	7	ish-mensa
15	Pjetër Marash Vukzaj	2	ish-mensa
16	Petrit Mal Sylaj	5	1
17	Valdete Rustem Buçpapa	1	1
18	Shpëtim Ali Nakaj	2	1
19	Altin Nikoll Pergjegjaj	2	1
20	Halit Lleshi	5	1
21	Idriz Rexhep Kosumaj	6	2
22	Seit Islam Bushi	4	1
23	Ramiz Syla	4	2
24	Naim Dedja	2	2
25	Gjyste Ndok Madani	4	1
26	Marash Zef Gjoni	4	sallë
27	Drita Topuzi	2	1
28	Destan Dylejman Disha	4	2
29	Minah Murat Rexha	1	2
30	Avni Destan Puçi	5	1
31	Sulejman Ramazan Emini	2	1
32	Hysen Nezir Balla	4	1
33	Aishe Ramiz Balla	1	1
34	Mehmet Ram Nikoçi	3	1
35	Saimir Mehmet Nikoçi	2	1
36	Dilaver Aqif Lica	5	1
37	Imer Selman Xhauri	4	1
38	Fiqeri Idajet Shehi	4	2
39	Agron Ismail Losha	2	1
40	Fetije Shaban Boçi	5	2
41	Lindita Ali Isufi	1	1

42	Nesim Imer Arifaj	3	1
43	Xhevdet Selman Tanushi	6	1
44	Avdi Hasula	4	1
45	Gjele Nikoll Doçi	1	1
46	Ramiz Cim Madani	5	2
47	Lulash Marash Vukza	4	sallë
48	Shkurte Hysen Demaj	6	2
49	Fatmir Syl Ndreaj	3	2
50	Lulzim Ibrahim Ibrahimi	5	1
51	Avdi Jak Sylaj	4	2
52	Pal Kolukaj	5	2
53	Sherif Deli Malaj	3	2
54	Xhemile Ukë Buçpapaj	2	1
55	Florentina Skënder Buçpapaj	3	1
56	Arben Islam Doçi	3	1
57	Islam Veli Doçi	2	1
58	Kujtim Cem Madani	9	1
59	Idriz Rexhep Shabani	4	1
60	Aranit Idriz Shabani	4	1
61	Ibrahim Rustem Aliaj	4	2
62	Agron Ahmet Buçaj	5	2
63	Erzen Din Sokolaj	3	1
64	Nep Sulejman Sokolaj	3	1
65	Pëllumb Bajram Baja	4	2
66	Nikoll Ndrec Pergjegjaj	6	1
67	Mustaf Idriz Byberi	5	2
68	Fatjon Mustaf Byberi	2	1
69	Selman Çera	5	1
70	Ruki Isuf Imeraj	6	1
71	Musa Rexhep Kosumi	6	sallë (kt. 4)
72	Përparim Gani Murati	4	1
73	Ndue Fran Mulaj	5	1
74	Bardhok Zef Marku	3	1
75	Flamur Haxhi Imeraj	3	1
76	Gjon Lek Zefi	7	1
77	Ermir Ahmet Kovaçi	2	1
78	Elmie Halit Kovaçi	4	1
79	Ardian Lek Zefi	5	2
80	Çetnik Ahmet Kovaçi	5	1
81	Uk Man Dema	5	2
82	Haxhi Avdyl Imeraj	6	1
83	Imer Suldisha	4	sallë
84	Muj Halil Selimi	5	2
85	Qazim Hamit Greçi	5	2
86	Kujtim Bilal Hajdari	5	2
87	Lulzim Haxhi Imeraj	5	1
88	Skënder Haxhi Imeraj	6	2
89	Artur Suldisha	3	1
90	Flamur Laçi	1	1

106 dhoma + 8 salla + 3 mensa

LISTA EMËRORE E BANORËVE QË BANOJNË TE LAVANDERIA

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Numri i frymëve	Numri i dhomave që posedojnë
1	Asllan Ramazan Kuka	5	3
2	Avni Rustem Cara	4	1
3	Petrit Ilmi Xhaferi	4	2

VENDIM
Nr. 416, datë 15.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 89, DATË 16.1.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2013", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i katërt i pikës 4.22 të vendimit nr. 89, datë 16.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë vijon:

"4.22 Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t'i shtohet fondi prej 200 (dyqind) milionë lekësh nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar për vitin 2013 për të përballuar efektet financiare të këtij kompensimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 417, datë 15.5.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASES BRUNILDA HYKA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në zërin "Mallra dhe shërbime", t'i shtohet fondi prej 300 000 (treqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të shtetases Brunilda Hyka.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 418, datë 15.5.2013

PËR RRITJEN E AKSIONEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KAPITALIN E BANKËS SË DETIT TË ZI PËR TREGTI DHE ZHVILLIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7969, datë 20.7.1995 "Për ratifikimin e marrëveshjes për krijimin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim" dhe të nenit 2 të ligjit nr. 113/2013 "Për aderimin në rezolutën e bordit të guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB)", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aksionet e Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim rriten për shumën 20 (njëzet) milionë SDR, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 113/2013 "Për aderimin në rezolutën e bordit të guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB)".
2. Autorizimin e Ministrisë së Financave të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e shtesës së aksioneve në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nga të cilat 30% do të paguhet në lekë (e barasvlershme me shumën 6 (gjashtë) milionë SDR) dhe 70% me notë premtimi. Pagesa prej 6 (gjashtë) milionë SDR do të bëhet nga Buxheti i Shtetit, sipas skedulit të mëposhtëm:

Viti 2013	500 mijë	SDR
Viti 2014	1 milion	SDR
Viti 2015	1 milion	SDR
Viti 2016	1 milion	SDR
Viti 2017	1 milion	SDR
Viti 2018	1.5 milionë	SDR

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 419, datë 15.5.2013

PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 shkronjat "ç", "d" e "e" dhe 7, pika 1 të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, të neneve 17 e 18 të ligjit nr. 10 303, datë 15.7.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)" dhe të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, për vitin 2013, me vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, deri në 1 000 000 (një milion) lekë, por në asnjë rast më shumë se 50 për qind të vlerës së kostove të pranueshme. Në kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:

a) investime, të prekshme dhe të paprekshme, në formën e përmirësimeve teknologjike, për përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konfromiteti dhe zbatim të sistemeve të cilësisë;

b) shërbime këshillimore, në formën e studimeve të tregut dhe të trajnimeve;

c) pjesëmarrje, për herë të parë, në një panair ose ekspozitë jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

3. Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) prodhojnë produkte ose ofrojnë shërbime, që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel ndërkombëtar dhe që, gjatë procesit, i japin një vlerë të shtuar, të konsiderueshme produktit përfundimtar;

b) kanë një strategji dhe plan marketingu për zgjerimin e eksporteve;

c) janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij.

4. Pagesa e subvencionit të bëhet në fund të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare, gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, me një vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për secilin vit.

6. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.

7. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

9. Vendimi nr. 112, datë 21.2.2007 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 421, datë 15.5.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 538, DATË 26.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LICENCAT DHE LEJET, QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 e 36 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të nenit 121 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 9 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 6 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në fushën VII "Transporti", të aneksit 1 "Kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet QKL-së", që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, të përfshihen përkatësisht licencat e nënkategorive: VII.3.A "Autoshkollat", VII.4 "Transport ndërkombëtar detar i automjeteve dhe/ose udhëtarëve", VII.5 "Për shërbime portuale", VII.6 "Për shërbime hekurudhore" dhe VII.7 "Për shërbime aeroportuale".

Kriteret e posaçme të përcaktohen sipas nënkategorive përkatëse, si më poshtë vijon:

"FUSHA VII
TRANSPORTI

KATEGORIA VII.3
SHËRBIME EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE TË LIDHURA ME TRANSPORTIN RRUGOR

1. Veprimtaritë "Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor" bëjnë pjesë në kategorinë VII.3 të trajtuar në shtojcën bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

2. Kategoria e kësaj veprimtarie përfshin licencën e nënkategorisë VII.3.A "Autoshkollë".

3. Veprimtaritë e nënkategorisë VII.3.A, specifikohen në:

a) "Autoshkollë për dhënien e lejes së drejtimit", me kodin VII.3.A.1, ku futen kategoritë e mëposhtme:

i) kategoria A;
ii) kategoria B;
iii) kategoria C;
iv) kategoria D;
v) kategoria BE;
vi) kategoria CE;
vii) kategoria DE.

b) "Autoshkollë për dhënien e certifikatës së aftësisë profesionale", me kodin VII.3.A.2, ku futen kategoritë e mëposhtme:

i) KC;

ii) kategoria KC+E;
iii) kategoria KD;
iv) kategoria KD+E.
c) "Autoshkollë për dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale", me kodin VII.3.A.3, ku futen:
i) automakinist;
ii) ekskavatorist;
iii) buldozerist.
4. Licenca për veprimtaritë me kodin VII.3.A jepet për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit.
5. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese për nënkategorinë VII.3.A jepen në tabelën 1, si më poshtë:

Tabela 1

Kriteret e posaçme	**Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme**	**Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme**
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit	Drejtuesi teknik i përgjithshëm (sipas specifikimeve); Instruktorët e praktikës	a) Certifikatë për drejtuesin teknik të përgjithshëm; b) Certifikatë për instruktorët e praktikës; c) Akte që provojnë marrëdhëniet e kërkuara të punës
